

20090941805

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Në përputhje me nenin 18-a paragrafi 2 të ligjit “Për armët” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 7/2005, 47/2006 dhe 86/2008), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TE MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR QITJET EKSPERIMENTALE, MËNYRËN E REALIZIMIT TË QITJEVE EKSPERIMENTALE DHE RUAJTJEN E FISHEKËVE NGA ARMËT E PËRDORURA PËR QITJET EKSPERIMENTALE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo Rregullore rregullon përbërjen e komisioneve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për qitjet eksperimentale, mënyrën e realizimit të qitjeve eksperimentale dhe ruajtjen e fishekëve nga armët e përdorura për qitjet eksperimentale.

II. PËRBËRJA E KOMISIONEVE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR QITJET EKSPERIMENTALE

Neni 2

Për realizimin e qitjeve eksperimentale në përputhje me ligjin “Për armët”, Ministri i Punëve të Brendshme do të krijojë tetë komisione (në vijim referuar si: Komisionet) të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në vijim referuar si: Ministria) për realizimin e qitjeve eksperimentale në fushën e tetë Sektorëve të Punëve të Brendshme të Ministrisë, me propozim të përgjegjësit të sektorit përkatës.

Neni 3

Komisionet përbëhen nga kryetari, tre anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Kryetari dhe zëvendësi i tij/saj, si edhe një anëtar dhe zëvendësi i tij/saj janë oficer policie në uniformë, ndërsa një anëtar dhe zëvendësi i tij/saj vijnë nga njësia organizative për çështjet civile dhe njësia organizative e kriminalistikës (një kryetar dhe tre anëtarë). Kryetari, anëtarët dhe zëvendësit e kryetarit dhe të anëtarëve janë punonjës të Sektorit të Punëve të Brendshme kompetent në fushën për të cilën është formuar komisioni.

III. MËNYRA E REALIZIMIT TË QITJEVE EKSPERIMENTALE

Neni 4

Qitjet kryhen në objekte të cilat plotësojnë kërkesat e parashikuara në Rregulloren për kërkesat minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet në poligonet civile të qitjes.

Neni 5

Anëtarët e komisioneve gjatë procesit të qitjeve eksperimentale duhet të jenë të veshur me uniformë mbrojtëse.

Përpara se të procedohet me qitjet eksperimentale duhet të hiqen fishekët nga qitjet e

mëparshme.

Qitjet kryhen nga një anëtar i Komisioneve – një oficer policie në uniformë, me plumba të cilat i siguron pronari i armës ose Ministria e Punëve të Brendshme (Komisionet), por shpenzimet i mbulon pronari i armës, në prani të një mjeku profesionist. Pronari i armës duhet të jetë i pranishëm gjatë procedurës së kryerjes së qitjeve.

Neni 6

Gjetjen, mbledhjen dhe paketimin e fishekëve e realizon anëtari i Komisionit nga njësia e kriminalistikës.

Paketimi i fishekëve kryhet në kuti alumini, qese plastike ose paketime të përshtatshme për këtë qëllim.

Shënjimim i fishekëve të paketuara (siguruara) e kryen anëtari i Komisionit nga njësia organizative për çështjet civile.

Neni 7

Për qitjen e realizuar kryetari i Komisionit harton një raport, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit.

Neni 8

Transportimi i fishekëve nga qitjet drejt ambienteve të njësisë përkatëse organizative për çështjet civile kryhet nga ana e Komisioneve menjëherë pas përfundimit të qitjes, në mënyrë të sigurt dhe të besueshme me automjete të Ministrisë të shënjura qartë.

Neni 9

Pas marrjes në dorëzim të fishekëve, njësia organizative për çështjet civile i vendos një numër unik identifikimi fishekëve të armës me të cilën është realizuar qitja.

IV. RUAJTJA E FISHEKËVE NGA ARMËT E PËRDORURA PËR QITJET EKSPERIMENTALE

Neni 10

Komisionet marrin në dorëzim fishekët nga qitjet, të cilëve u është vendosur një numër unik identifikimi, dhe i dërgojnë te Departamenti i Kriminalistikës në Drejtorinë Qendrore të Policisë të Agjencisë Shtetërore të Sigurisë në Ministri, ku fishekët do të ruhen në një dhomë të veçantë (depo, magazina) në mënyrë të centralizuar.

Dhoma e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të përdoret vetëm për ruajtjen e fishekëve nga qitjet dhe do të jetë në ruajtje dhe sigurim teknik të veçantë.

Në dhomën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, fishekët e magazinuar duhet të jenë të shënjuar qartë, të seleksionuar dhe të klasifikuar në mënyrë të atillë që të jetë i mundur gjurmimi efikas dhe i shpejtë i numrit unik të identifikimit.

Për fishekët e magazinuar në dhomën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të mbahen regjistra.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën pas botimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”

Nr. 14.1-48133/1
21 korrik 2009
Shkup

Ministre
e Punëve të Brendshme,
MA Gordana Jankuloska, nënshkrimi